BAZAT E QEVERISJES EUROPIANE

CIKËL LEKSIONESH



Botimi i II-të – 2026

Dr. Arjan GJINI

EUROPEAN COMMISSION • ERASMUS+ JEAN MONNET MODULE 2025

BAZAT E QEVERISJES EUROPIANE

CIKËL LEKSIONESH

Dr. Arjan GJINI

Botimi i II-të – Gjirokastër, 2026

PROJEKTI: EU4EduGovRegAL – EU Education for Better Governance in the Regions of Albania | PROGRAMI: Erasmus+ Jean Monnet Module 2025 | INSTITUCIONI ZBATUES: Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej"

Komunikimi, Dukshmëria dhe Njohja e Financimit nga BE-ja: Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit *EU4EduGovRegAL*, një modul i programit Erasmus+ Jean Monnet 2025, i zbatuar nga Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej", dhe përbën një produkt shkencor të këtij projekti. **Mohimi i Përgjegjësisë (Disclaimer):** Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Europian ose të Agjencisë Ekzekutive Europiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Europian dhe as autoriteti financues nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

Communication, Visibility & Funding Acknowledgement: This publication has been produced within the framework of the project *EU4EduGovRegAL*, an Erasmus+ Jean Monnet Module 2025, implemented by the University of Gjirokastra "Eqrem Çabej". **Disclaimer:** Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.

PARATHËNIE

Ky libër trajton qeverisjen në Bashkimin Europian (BE) përmes një qasjeje akademike që shqyrton jo vetëm institucionet dhe proceset e vendimmarrjes, por sidomos rezultatet e tyre në terma të politikave publike, standardeve rregullatore dhe ndikimit mbi qytetarin. Qeverisja europiane përbën sot një nga modelet më të avancuar të administrimit publik dhe të politikëbërjes në kushtet e ndërvarësisë globale.

Si tekst universitar, ai ofron një kornizë studimi sistematike për të kuptuar arkitekturën institucionale të BE-së, logjikën e qeverisjes shumë-nivelëshe dhe mekanizmat e zbatimit, monitorimit dhe llogaridhënies, duke e vendosur administrimin publik në rolin e nyjës vendimtare që e përkthen vendimmarrjen politike në veprim administrativ dhe shërbime konkrete.

Në një epokë të shnwuar nga pasiguria gjeopolitike, krizat energjetike, presionet migratore, kërcënimet hibride, si edhe nga tranzicioni i gjelbër dhe transformimi digjital, BE-ja mbetet një projekt institucional që synon ta kthejë diversitetin në kohezion dhe konkurrencën e interesave në rend rregullator. Në kushtet e Inteligjencës Artificiale dhe të dhënave të hapura (*open data*), qeverisja europiane po forcon vendimmarrjen e bazuar në evidencë dhe transparencë, duke zgjeruar përfshirjen qytetare, rritur llogaridhënien dhe konsoliduar rolin e Europës si standardvendosëse globale. Në këtë kuadër, teksti nuk synon të jetë kronikë shteruese e historisë së integrimit europian; ai ofron një instrument analitik të orientuar drejt praktikës dhe zbatimit.

Lënda është organizuar në pesëmbëdhjetë tema që ndërtojnë një rrugëtim të plotë: nga hyrja në BE, traktatet themelore, kompetencat, politikat dhe statusi i nëpunësit publik, te shpjegimi i shtetit dhe i qeverisjes në Shqipëri në raport me integrimin. Më tej, vëmendja fokusohet te institucionet dhe organet kyçe të qeverisjes europiane – Parlamenti Europian, Komisioni Europian dhe roli i Presidentit të tij, Gjykata e Drejtësisë e BE-së, Gjykata Europiane e Auditëve, Komiteti i Rajoneve dhe Banka Qendrore Europiane, duke analizuar funksionet e tyre, instrumentet e veprimit dhe balancat e pushteteve.

Një rëndësi e posaçme i kushtohet mekanizmave të kontrollit administrativ, etikës institucionale dhe mbrojtjes së të drejtave: Avokati i Popullit Europian dhe Mbikëqyrësi Europian për Mbrojtjen e të Dhënave trajtohen si shtylla të administrimit të përgjegjshëm dhe të qeverisjes së hapur. Krahas dimensionit institucional, lënda integron perspektiva mbi organizatat ndërkombëtare dhe rolin ndërkombëtar të BE-së, sistemet zgjedhore në Europë dhe bazat e së drejtës së BE-së dhe *Acquis*, në mënyrë që studenti të kuptojë qeverisjen si sistem të ndërlidhur normash, institucionesh dhe praktikash zbatimi.

Për Shqipërinë, kjo qasje ka vlerë të veçantë formuese. Procesi i afrimit me BE-në nuk është thjesht përputhshmëri formale; ai është proces transformues i shtetit dhe administratës, ku sfida kryesore qëndron te kalimi nga miratimi i normave te përputhshmëria efektive dhe cilësia e shërbimeve publike. Edhe pse vendi përballet me sfida qeverisëse, ai mbart vlera shoqërore të rëndësishme: solidaritet, energji rinore dhe vitalitet komunitar, të cilat mund të shndërrohen në kapital reformues kur mbështeten nga institucione funksionale, integritet dhe kapacitete profesionale.

Ky botim u drejtohet studentëve dhe profesionistëve të administratës publike me synimin të kultivojë kërkimin e pavarur dhe diskursin profesional të mbështetur në burime zyrtare të BE-së. Ai synon të ndihmojë lexuesin të lexojë institucionet përmes funksioneve të tyre, të analizojë politikat përmes ciklit të tyre të jetës dhe të kuptojë se si standardi europian i qeverisjes materializohet në procedura administrative, akte nënligjore, praktika kontrolli dhe shërbime për qytetarin. Në këtë mënyrë, studimi i qeverisjes europiane shndërrohet në formim profesional – një ftesë për të menduar dhe vepruar si administratë moderne, e aftë të përballojë sfidat e sotme dhe të përgatisë institucionet për shekujt që vijnë.

Me vetëdijen për kufizimet metodologjike, ky tekst nuk synon të mbulojë shterueshëm të gjitha proceset e BE-së, por të ofrojë një qasje të orientuar drejt praktikës që forcon ndërveprimin universitet–individ/shoqëri–administratë, adreson mangësitë e njohjes institucionale në administratën vendase dhe përgatit studentë e nëpunës civilë të aftë të përballojnë sfidat e qeverisjes sot, duke u shndërruar në kontribuues aktivë në qeverisjen e Bashkimit Europian. Ky botim i përmend brezit të ri se qeverisja e mirë nuk është vetëm çështje vullneti politik, por është një shkencë ekzakte e mbështetur në të dhëna, integritet dhe teknologji të avancuar.

Historia e Europës nuk ka qenë e lehtë, por triumfi i racionalitetit dëshmon se Europa zgjodhi të ndërtonte një "Kushtetutë të Paqes", ku ligji është mjeti i vetëm i pranueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e shndërruar kontinentin nga një teatër tragjedish në një model të qeverisjes globale. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për kolegët, institucionet mbështetëse dhe studentët, reflektimet dhe përvoja e të cilëve kanë ndihmuar në formësimin e këtij botimi sipas nevojave reale të qeverisjes sot.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Tema / Nëntemat e Ciklit të Leksioneve	Faqja
TEMA I – 1. HYRJE NË BE	
1.1 Qeverisja në BE	**20**
1.2 Historia e integrimit europian dhe rëndësia e BE-së sot	**26**
1.3 Traktatet themelore (TEU, TFEU, Karta e të Drejtave)	**30**
1.4 Institucionet në BE	**38**
1.5 Statusi i nëpunësit publik në BE	**44**
1.6 Kompetencat e BE-së: ekskluzive, të përbashkëta, mbështetëse	**47**
1.7 Politikat dhe prioritetet e agendës së BE-së, dhe procesi i zgjerimit	**52**
TEMA II – 2. ZHVILLIMI I SHTETIT NË SHQIPËRI DHE QEVERISJA SOT	
2.1 Evolucioni kushtetues në Republikën e Shqipërisë	**60**
2.2 Nivelet e qeverisjes: qendrore, vendore, sistemi gjyqësor dhe agjencitë e pavarura	**63**
2.3 Reforma administrative-territoriale dhe decentralizimi	**65**
2.4 Integrimi europian: mekanizmat institucionalë dhe koordinimi	**67**
2.5 Qeverisja bashkëkohore: transparenca, pjesëmarrja, digjitalizimi	**70**
TEMA III – 3. PARLAMENTI EUROPIAN	
3.1 Roli, organizimi, kompetencat dhe funksioni i PE-së	**80**
3.2 Zgjedhjet europiane dhe grupet politike	**86**
3.3 Procedurat legjislative	**92**
3.4 Mbikëqyrja ndaj Komisionit dhe institucioneve	**94**

Tema / Nëntemat e Ciklit të Leksioneve	Faqja
3.5 Marrëdhëniet me parlamentet kombëtare	96
TEMA IV – 4. KOMISIONI EUROPIAN	
4.1 Roli dhe funksioni ekzekutiv, emërimi dhe përbërja e Komisionit Europian	102
4.2 Nisma ligjvënëse dhe agjenda e politikave	107
4.3 Zbatimi i ligjit të BE-së	109
4.4 Menaxhimi i buxhetit dhe programeve	110
4.5 Komisioni si përfaqësues ndërkombëtar i BE-së	112
TEMA V – 5. PRESIDENTI I KE-së	
5.1 Zgjedhja, mandati dhe funksioni	118
5.2 Roli strategjik, mbrojtja e interesave dhe përcaktimi i prioriteteve të BE-së	119
5.3 Formimi, organizimi dhe shpërndarja e portofolave	121
5.4 Marrëdhëniet me Këshillin Europian dhe PE-në	123
5.5 Komunikimi publik dhe diplomacia politike	125
5.6 Llogaridhënia dhe etika institucionale	128
TEMA VI – 6. GJYKATA E DREJTËSISË E BE-së	
6.1 Roli, funksioni dhe struktura: Gjykata & Gjykata e Përgjithshme	133
6.2 Procedurat: pyetjet paraprake, paditë për shkelje	136
6.3 Parimet: përparësia dhe efekti i drejtpërdrejtë	139
6.4 Roli në harmonizimin e së drejtës së BE-së	141
TEMA VII – 7. GJYKATA EUROPIANE E AUDITËVE	
7.1 Mandati dhe kompetencat e auditimit të fondeve	150
7.2 Auditimet: rregullshmëria dhe performanca	152
7.3 Raporti vjetor dhe ndikimi në menaxhimin financiar	154
7.4 Bashkëpunimi me OLAF dhe institucione të tjera	157
7.5 Transparenca dhe përgjegjshmëria ndaj qytetarëve	159
TEMA VIII – 8. KOMITETI I RAJONEVE	
8.1 Roli dhe rëndësia e Komitetit të Rajoneve	169
8.2 Përbërja: përfaqësues vendorë/rajonalë	172
8.3 Opinionet për aktet ligjore të BE-së	175
8.4 Bashkëpunimi ndërrajonal	177
8.5 Ndikimi në politikën e kohezionit	179

Tema / Nëntemat e Ciklit të Leksioneve	Faqja
TEMA IX – 9. BANKA QENDRORE EUROPIANE	
9.1 Roli dhe funksioni i BQE-së	**189**
9.2 Politika monetare: normat, operacionet e tregut të hapur	**190**
9.3 Unioni Bankar dhe mbikëqyrja	**192**
9.4 Instrumentet jo-konvencionale	**194**
9.5 Roli në kriza dhe koordinimi me politikat fiskale	**196**
TEMA X – 10. AVOKATI I POPULLIT EUROPIAN (Ombudsman)	
10.1 Jurisdiksioni dhe kompetencat. Procedurat e ankesave dhe hetimet *ex-officio*	**203**
10.2 Transparenca, qasja në dokumente dhe etika	**205**
10.3 Rekomandimet jo-detyruese dhe ndikimi praktik	**208**
10.4 Raste studimore analizuese për administratën	**210**
TEMA XI – 11. MBIKËQYRËSI EUROPIAN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE	
11.1 Mandati dhe parimet e privatësisë në BE	**219**
11.2 Zbatimi i GDPR dhe rregullave institucionale	**222**
11.3 Këshillimi i institucioneve për politika të reja	**224**
11.4 Teknologjitë e reja: AI, biometrika, transferimet ndërkufitare	**227**
11.5 Bashkëpunimi me autoritetet kombëtare	**228**
TEMA XII – 12. ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE BOTËRORE	
12.1 Klasifikimi: universale, rajonale, funksionale	**236**
12.2 OKB, Këshilli i Evropës, OSBE – rolet kryesore	**238**
12.3 Marrëdhëniet BE – Organizata Ndërkombëtare dhe statusi ndërkombëtar i BE-së	**240**
12.4 OI ekonomike: WTO, FMN, Banka Botërore, OECD	**243**
12.5 Anëtarësimi i Shqipërisë dhe bashkërendimi i politikave	**244**
TEMA XIII – 13. SISTEMET ZGJEDHORE NË EUROPË	
13.1 Sistemet kryesore zgjedhore (mazhoritare, proporcionale dhe të përziera)	**251**
13.2 Pragu elektoral dhe rishpërndarja e mandateve	**254**
13.3 Listat e hapura/mbyllura dhe votimi preferencial	**256**
13.4 Administrimi zgjedhor dhe standardet e OSBE/ODIHR	**258**
13.5 Trendet e reformave dhe pjesëmarrja qytetare	**261**
TEMA XIV – 14. E DREJTA EUROPIANE	
14.1 Legjislacioni në BE, *Acquis*. Hierarkia dhe zbatimi	**268**

Tema / Nëntemat e Ciklit të Leksioneve	Faqja
14.2 E drejta e tregut të brendshëm dhe katër liritë	271
14.3 Politikat horizontale: mjedisi, konkurrenca, ndihma shtetërore	273
14.4 Mekanizmat e zbatimit dhe sanksionimit	275
TEMA XV – 15. ROLI I INDIVIDIT NË QEVERISJE DHE POLITIKA PUBLIKE	
15.1 Mbrojtja e të drejtave të individit në Europë dhe risku që bota paraqet	284
15.2 Pjesëmarrja qytetare: konsultime, peticione, Nisma Europiane e Qytetarëve	286
15.3 Transparenca dhe qasja në informacion: aktivizmi, shoqëria civile dhe media	288
15.4 Etika publike, konfliktet e interesit dhe integriteti	289
15.5 Kompetencat digjitale qytetare për politikë – shembuj praktikë	291
BIBLIOGRAFIA	297

ABSTRAKTET E TEMAVE (TEMA I – TEMA XV)

Ky seksion përmbledh në formë analitike objektivat, bazën kushtetuese-juridike dhe boshtin konceptual të secilës prej pesëmbëdhjetë temave të ciklit të leksioneve, duke shërbyer si udhëzues akademik për leximin e botimit të plotë.

TEMA I. Hyrje në Bashkimin Europian (Tekst i plotë: fq. 20–59)

Trajton evolucionin historik dhe arkitekturën kushtetuese të Bashkimit Europian si një sistem *sui generis* i qeverisjes shumë-nivelëshe, duke nisur nga Deklarata Schuman (1950) dhe komunitetet themeluese deri te Traktati i Lisbonës (TEU, TFEU dhe Karta e të Drejtave Themelore me vlerë të barabartë juridike). Analizon kuadrin e përbashkët institucional (Neni 13 TEU), parimet e ndarjes së kompetencave (ekskluzive, të përbashkëta dhe mbështetëse) të udhëhequra nga subsidiariteti dhe proporcionaliteti, statusin e shërbimit civil europian (EPSO) dhe parimet e Hapësirës Administrative Europiane (SIGMA/OECD), si dhe politikat strategjike dhe procesin e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor.

TEMA II. Zhvillimi i Shtetit në Shqipëri dhe Qeverisja Sot (Tekst i plotë: fq. 60–79)

Analizon transformimin kushtetues dhe institucional të shtetit shqiptar nga sistemi monist te demokracia parlamentare e sanksionuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe Reformën në Drejtësi (2016). Shqyrton arkitekturën e pushteteve (qendror, vendor, gjyqësor dhe organet e pavarura kushtetuese), reformën administrativo-territoriale (Ligji nr. 115/2014) dhe decentralizimin fiskal e funksional (Ligji nr. 139/2015), mekanizmat shtetërorë të koordinimit të negociatave të aderimit (Urdhri nr. 93/2019 dhe Ligji nr. 15/2015), si dhe modernizimin e administratës përmes transparencës, digjitalizimit (e-Albania) dhe pjesëmarrjes qytetare.

TEMA III. Parlamenti Europian (Tekst i plotë: fq. 80–101)

Shqyrton rolin dhe evolucionin e Parlamentit Europian (PE) si i vetmi institucion i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e Unionit që prej vitit 1979 (Neni 14 TEU). Analizon organizimin e brendshëm përmes grupeve politike transnacionale (në vend të delegacioneve kombëtare), rolin si bashkëligjvënës i barabartë me Këshillin e BE-së në Procedurën e Zakonshme Legjislative (Neni 294 TFEU) dhe procedurën buxhetore, mekanizmat e kontrollit politik e demokratik mbi Komisionin Europian (përfshirë mocionin e mosbesimit dhe komisionet hetimore), si dhe bashkëpunimin me parlamentet kombëtare në mbrojtje të parimit të subsidiaritetit.

TEMA IV. Komisioni Europian (Tekst i plotë: fq. 102–117)

Analizon natyrën dyfishe të Komisionit Europian si organ ekzekutiv mbikombëtar dhe "Mbrojtës i Traktateve" (Neni 17 TEU). Trajton procedurën e dyfishtë të legjitimimit demokratik të Kolegjit të Komisionerëve, monopolin e iniciativës legjislative dhe agjendën për Rregullim më të Mirë (*Better Regulation*), mekanizmat e zbatimit dhe kontrollit të ligjit të BE-së (aktet e deleguara dhe zbatuese sipas Neneve 290–291 TFEU, si dhe procedurat e shkeljes sipas Nenit 258 TFEU), menaxhimin e Kuadrit Shumëvjeçar Financiar (MFF) dhe fondeve të para-anëtarësimit IPA III, si dhe përfaqësimin e jashtëm të Unionit.

TEMA V. Presidenti i Komisionit Europian (Tekst i plotë: fq. 118–132)

Studion procesin e "presidencializimit" të ekzekutivit evropian dhe forcimin e autoritetit kushtetues të Presidentit të Komisionit Europian (Neni 17(6) TEU). Analizon mekanizmin e emërimit dhe sistemin *Spitzenkandidaten*, kompetencat e udhëheqjes strategjike dhe përcaktimit të prioriteteve politike (Komisioni Gjeopolitik, Marrëveshja e Gjelbër dhe Busulla Digjitale), strukturimin e Kolegjit përmes Zëvendëspresidentëve Ekzekutivë dhe letrave të misionit, ndërveprimin me Këshillin Europian dhe Parlamentin Europian, diplomacinë publike dhe standardet e etikës e llogaridhënies institucionale.

TEMA VI. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian (GJEDBE) (Tekst i plotë: fq. 133–149)

Analizon autoritetin suprem gjyqësor të Unionit me seli në Luksemburg, i cili garanton respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve (Neni 19 TEU) përmes dy shkallëve të tij: Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme. Shqyrton llojet kryesore të padive – veçanërisht mekanizmin e Referimit Paraprak (Neni 267 TFEU), paditë për shkelje (Nenet 258–260 TFEU) dhe paditë për anulim (Neni 263 TFEU) – si dhe rolin transformues të jurisprudencës së saj në themelimin e parimeve të efektit të drejtpërdrejtë (*Van Gend en Loos*), epërsisë (*Costa v. ENEL*) dhe përgjegjësisë shtetërore (*Francovich*).

TEMA VII. Gjykata Europiane e Auditëve (GEA) (Tekst i plotë: fq. 150–168)

Shqyrton mandatin dhe funksionimin e Gjykatës Europiane të Auditëve si institucioni i pavarur i auditimit të jashtëm të financave të BE-së (Nenet 285–287 TFEU). Analizon organizimin kolegjial, metodologjinë e auditimit financiar, të pajtueshmërisë dhe të performancës (parimet 3E: Ekonomi, Efiçiencë, Efektivitet), rëndësinë e Raportit Vjetor dhe Deklaratës së Sigurisë (DAS) në procedurën e shkarkimit buxhetor (*discharge*, Neni 319 TFEU), si dhe bashkëpunimin institucional me Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Zyrën e Prokurorit Publik Europian (EPPO), përfshirë auditimin e fondeve IPA.

TEMA VIII. Komiteti Europian i Rajoneve (CoR) (Tekst i plotë: fq. 169–188)

Trajton rolin e Komitetit Europian të Rajoneve si asambleja konsultative e përfaqësuesve të zgjedhur vendorë dhe rajonalë të BE-së (Nenet 300 dhe 305–307 TFEU), duke reflektuar faktin se rreth 70% e legjislacionit evropian zbatohet në nivel sub-kombëtar. Analizon kushtin e mandatit elektoral vendor të 329 anëtarëve, procedurat e konsultimit të detyrueshëm e fakultativ në fushat e kohezionit territorial, të drejtën kushtetuese të CoR-it për t'iu drejtuar GJEDBE-së në mbrojtje të parimit të subsidiaritetit (Protokolli Nr. 2), si dhe bashkëpunimin me bashkitë shqiptare përmes Këshillit të Përbashkët Konsultativ (JCC).

TEMA IX. Banka Qendrore Europiane (BQE / ECB) (Tekst i plotë: fq. 189–202)

Analizon arkitekturën dhe mandatin kushtetues të Bankës Qendrore Europiane si institucioni qendror i Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (EMU) dhe i Eurozonës (Nenet 127–133 dhe 282–284 TFEU). Shqyrton garancitë e larta të pavarësisë institucionale e financiare, objektivin parësor të stabilitetit të çmimeve (inflacioni 2% në afat të mesëm), dallimin ndërmjet SEBQ-së dhe Eurosistemit, organet vendimmarrëse (Këshilli Drejtues, Bordi Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm), instrumentet konvencionale dhe jokonvencionale të politikës monetare (QE, PEPP), si dhe mbikëqyrjen prudenciale përmes Mekanizmit të Vetëm Mbikëqyrës (SSM).

TEMA X. Avokati i Popullit Europian (European Ombudsman) (Tekst i plotë: fq. 203–218)

Studion mandatin dhe mekanizmat e veprimit të Avokatit të Popullit Europian si organ i pavarur i zgjedhur nga Parlamenti Europian për të mbajtur përgjegjëse administratën e BE-së (Neni 228 TFEU dhe Vendimi 2021/1163). Analizon konceptin e "keqadministrimit" (*maladministration*) në lidhje me të drejtën themelore për administrim të mirë (Neni 41 i Kartës së të Drejtave Themelore), procedurat e shqyrtimit të ankesave dhe hetimet *ex-officio*, promovimin e transparencës e etikës administrative (rasti i "dyerve rrotulluese"), si dhe fuqinë praktike të rekomandimeve jodetyruese dhe Raporteve Speciale.

TEMA XI. Mbikëqyrësi Europian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPS) (Tekst i plotë: fq. 219–235)

Trajton kuadrin kushtetues dhe ligjor të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale në Bashkimin Europian (Neni 16 TFEU dhe Nenet 7–8 të Kartës së të Drejtave Themelore). Analizon mandatin mbikëqyrës, këshillues dhe bashkëpunues të EDPS-së sipas Rregullores (BE) 2018/1725 në raport me zbatimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR – 2016/679) dhe rolin e Bordit Europian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB). Shqyrton sfidat rregullatore të teknologjive të reja (Inteligjenca Artificiale, biometrika dhe transferimet ndërkufitare) dhe përafrimin legjislativ në Shqipëri.

TEMA XII. Organizatat Ndërkombëtare dhe Botërore (Tekst i plotë: fq. 236–250)

Shqyrton teorinë e organizatave ndërkombëtare si subjekte sekondare me personalitet juridik të derivuar në të drejtën ndërkombëtare publike dhe tipologjinë e tyre (universale, rajonale, funksionale; ndërqeveritare dhe mbikombëtare). Analizon strukturën dhe mandatin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO), Këshillit të Europës (CoE dhe GJEDNJ), OSBE-së dhe institucioneve ekonomike-financiare globale (FMN, Banka Botërore, OBT, OECD), duke vendosur në fokus statusin ndërkombëtar të BE-së dhe anëtarësimin e Shqipërisë në sistemin multilateral.

TEMA XIII. Sistemet Zgjedhore në Europë (Tekst i plotë: fq. 251–267)

Analizon trashëgiminë zgjedhore europiane të kodifikuar nga Komisioni i Venecias mbi pesë parimet kushtetuese të votës (universale, e barabartë, e lirë, e fshehtë dhe e drejtpërdrejtë). Krahason familjet kryesore të sistemeve zgjedhore (mazhoritare, proporcionale dhe të përziera), ndikimin politik të pragjeve elektorale dhe formulave matematikore të mandatimit (D'Hondt vs. Sainte-Laguë), efektet e listave të hapura e të mbyllura, standardet e administrimit zgjedhor të OSBE/ODIHR, si dhe tendencat bashkëkohore të votimit elektronik, votës së diasporës dhe uljes së moshës së votimit.

TEMA XIV. E Drejta Europiane (Tekst i plotë: fq. 268–283)

Paraqet arkitekturën e rendit juridik autonom të Bashkimit Europian dhe piramidën e burimeve të së drejtës (e drejta primare, parimet e përgjithshme, marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e së drejtës sekondare sipas Nenit 288 TFEU: rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet dhe opinionet). Analizon bazat juridike të Tregut të Brendshëm dhe Katër Liritë themelore (mallrat, personat, shërbimet dhe kapitali), politikat horizontale me ndikim të lartë rregullator (konkurrenca, ndihma shtetërore, mjedisi), mekanizmat e sanksionimit dhe procesin e përafrimit të *Acquis Communautaire* në 35 kapitujt e negociatave.

TEMA XV. Roli i Individit në Qeverisje dhe Politika Publike (Tekst i plotë: fq. 284–296)

Analizon transformimin e statusit të individit nga subjekt pasiv i pushtetit në bashkëqeverisës aktiv dhe "auditues natyror" të politikave publike (Neni 11 TEU). Shqyrton mekanizmat e demokracisë pjesëmarrëse në BE (Iniciativa Qytetare Europiane – ECI, peticionet, konsultimet publike dhe e drejta e aksesit në dokumente sipas Rregullores 1049/2001), konceptin e transparencës radikale dhe *Open Data*, etikën publike e mbrojtjen e sinjalizuesve (*whistleblowers*), si dhe mbrojtjen e autonomisë së individit përballë rreziqeve të algoritmeve dhe dezinformimit përmes *EU AI Act* dhe *DSA*.

BIBLIOGRAFIA (Tekst i plotë: fq. 297)

1. Literatura Shkencore (Libra dhe Artikuj)

- Auby, J.-B. (2024). *Le droit administratif européen*. Paris: Bruylant.
- Bauer, M. W., & Knill, C. (2023). *European Public Policy and Administration*. München: LMU / Oxford University Press.
- Beck, U. (2022). *German Europe*. Polity Press.
- Bogdandy, A. von, & Grabenwarter, C. (2024). *The Essence of the European Constitution*. Heidelberg: Springer (Max Planck Institute).
- Börzel, T. A. (2023). *European Integration: Theory, Practice, and Analysis*. Berlin: De Gruyter.
- Cassese, S. (2023). *The Global Polity: Global Dimensions of Law and Governance*. Oxford University Press.
- Chiti, E. (2024). *Managing the Union's Complex Infrastructure*. Oxford: Oxford University Press.
- Chopin, T. (2024). *L'Europe et l'État*. Paris: Presses de Sciences Po.
- Costa, O., & Brack, N. (2023). *How the European Union Really Works* (Botimi i 4-t). London: Routledge.
- Craig, P., & de Búrca, G. (2024). *EU Law: Text, Cases, and Materials*. Oxford: Oxford University Press.
- Dawson, M. (2023). *The Governance of the European Union*. Berlin: Hertie School of Governance / Cambridge University Press.
- De Grauwe, P. (2023). *Economics of Monetary Union* (Botimi i 14-të). Oxford: Oxford University Press.
- Drechsler, W. (2024). *Innovation and the State: Digital Governance in the Era of AI*. Tallinn/Cambridge.

- Dutheil de la Rochère, J., & Blanquet, M. (2025). *Droit des relations institutionnelles de l'Union européenne*. Paris: LGDJ (Lextenso).
- Elbasani, A. (2023). *European Integration and Transformation in the Western Balkans*. London: Routledge.
- Fabbrini, F. (2024). *EU Fiscal Capacity: Legal and Institutional Issues*. Oxford University Press.
- Fischer, J. (2023). *Is Europe Failing?*. Polity Press.
- Fukuyama, F. (2014/2023). *Political Order and Political Decay: From the Industrial Revolution to the Globalization of Democracy*. New York: Farrar, Straus and Giroux.
- Govaere, I., & Garben, S. (2024). *The Interface Between EU and National Law*. Hart Publishing.
- Habermas, J. (2023). *The Lure of Technocracy: A German Perspective on the Eurozone*. Cambridge: Polity Press.
- Issing, O. (2024). *The Birth of the Euro and its Future*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Kaiser, A., & Hennings, V. (2025). Electoral Institutions and the Resilience of Democracy: A Comparative View. *Politische Vierteljahresschrift (PVS)*, 66.
- Kalogeropoulos, A. (2025). *The Inoculated Citizen: Pre-bunking Strategies and Media Literacy*. Oxford: Reuters Institute.
- Koprić, I. (2024). *Public Administration in Europe: Modernization and Europeanization*. Zagreb: Institute of Public Administration.
- Lenaerts, K., & Van Nuffel, P. (2024). *European Union Law*. Leuven: Oxford University Press.
- Lynskey, O. (2023). *The Foundations of EU Data Protection Law*. Oxford: Oxford University Press.
- Menasse, R. (2022). *The European Republic: Reflections on the Future of a Continent*. Berlin: Suhrkamp / London: Polity Press.
- Molina, I. (2024). *The Governance of the European Union: A Spanish Perspective*. Madrid: Real Instituto Elcano.
- Moravcsik, A. (2023). *The Choice for Europe: Social Purpose and State Power from Messina to Maastricht*. Ithaca, NY: Cornell University Press.
- Nohlen, D., & Grotz, F. (2025). *Electoral Systems and Democracy: A Global Perspective*. München: C.H. Beck / Nomos.
- Piattoni, S., & Schönlau, J. (2023). *The Committee of the Regions: The Voice of Cities and Regions in the EU*. London: Routledge.
- Piketty, T. (2024). *Manifesto for the Democratization of Europe*. Harvard University Press.
- Pisani-Ferry, J., & Wolff, G. (2024). *The New European Economic Governance*. Bruegel Blueprint Series.
- Pollack, J. (2024). *The European Union and Democracy: Representation and Legitimacy*. Vienna: Austrian Academy of Sciences.
- Pollitt, C., & Bouckaert, G. (2023). *Public Management Reform: A Comparative Analysis – Into the Age of Austerity*. Oxford University Press.
- Prandini, R., & Orlandini, G. (2025). *Relational Citizenship and Civic Participation in the European Union*. Berlin: Springer.
- Pukelsheim, F. (2025). *Proportional Representation: Apportionment Methods and Their Applications* (Botimi i 3-të). Berlin: Springer.
- Scharpf, F. W. (2023). *Governing in Europe: Effective and Democratic?*. Cologne: Max Planck Institute.
- Sommermann, K.-P. (2023). *European Public Law*. Berlin: Duncker & Humblot.
- Van Middelaar, L. (2024). *The Passage to Europe: How a Continent Became a Union*. Brussels/Leiden: Yale University Press / Leiden University Press.
- Verhofstadt, G. (2023). *Europe's Last Chance: Why the European States Must Form a More Perfect Union*. Basic Books.

- Walker, N. (2024). *The Constitutional Imaginary of Europe*. Oxford University Press.
- Wessels, W. (2024). *The European Union: A Systematic Analysis of the Institutional System* (Botimi i 2-të i përditësuar). London/New York: Routledge.
- Wolfrum, R. (2024). *The Structures of Governance in Europe*. Heidelberg: Max Planck Institute for Comparative Public Law and International Law / Springer.
- Zaganjori, Xh. (2022). *E drejta e Bashkimit Europian: Institucionet, rendi juridik, jurisprudenca dhe procesi i integrimit*. Tiranë: Pegi.
- Zaganjori, Xh. (2023). *Shteti i së drejtës dhe integrimi në BE: Sfidat e Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor*. Tiranë: Onufri.
- Zetzsche, D. A. (2024). *The Law of Business Systems in the Eurozone*. Frankfurt: Goethe University / Cambridge University Press.
- Ziller, J. (2025). *The European Administrative Space: Convergence and Diversity*. Paris/Oxford: Sciences Po Les Presses & Hart Publishing.

2. Raporte dhe Dokumente Strategjike

- Draghi, M. (2024). *The Future of European Competitiveness*. European Commission Strategic Report. Brussels: European Commission.
- Letta, E. (2024). *Much More Than a Market: Speed, Security, Solidarity. Empowering the Single Market to deliver a sustainable future and prosperity for all EU citizens*. Brussels: European Council / European Commission.
- SIGMA/OECD. (2024). *Principles of Public Administration: Albania Country Report*. Paris: OECD Publishing.

3. Aktet Juridike të Bashkimit Europian

- Bashkimi Europian. (2016). Version i konsoliduar i Traktatit mbi Bashkimin Europian (TEU) dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFEU). *Fletorja Zyrtare e BE-së*, C 202/01.
- Bashkimi Europian. (2012). Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian. *Fletorja Zyrtare e BE-së*, C 326/02.
- Parlamenti Europian dhe Këshilli. (2016). Rregullorja (BE) 2016/679 (GDPR) mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
- Komisioni Europian. (2024). *Communication from the Commission: 2024 Communication on EU Enlargement Policy – Albania Report*. Brussels.
- Komisioni Europian. (2024). *Manualet e Procedurave të Komisionit Europian: Interinstitutional Agreement on Better Law-Making*.
- Banka Qendrore Europiane. (2024). *The Monetary Policy of the ECB*. Frankfurt am Main: ECB Publications.
- Rregullorja (BE) 211/2011: Mbi Nismën e Qytetarëve Europianë (ECI).
- Banka Qendrore Europiane: Statuti i Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe i BQE-së (Nenet 127–133 të TFEU).
- Rregullorja (BE) Nr. 1024/2013: Mbi detyrat specifike të BQE-së lidhur me mbikëqyrjen prudenciale të institucioneve kreditore (Unioni Bankar).
- Manualet e Auditimit të Gjykatës Europiane të Auditëve (ECA): *Performance Audit Manual* dhe *Financial and Compliance Audit Manual*.
- Rregullorja (BE) 2018/1725: Mbi mbrojtjen e të dhënave nga institucionet e BE-së dhe mandatin e EDPS.
- Parlamenti Europian. (2021). Vendimi (BE) 2021/1163 mbi Statutin dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë ushtrimin e detyrave të Ombudsmanit.

- Akti Zgjedhor i PE-së (1976, i ndryshuar): Rregullat për zgjedhjet e drejtpërdrejta në Parlamentin Europian.

4. Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë

- Kuvendi i Shqipërisë. (1998). *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (e përditësuar me ndryshimet e vitit 2024). Tiranë: Fletorja Zyrtare.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2015). Ligji nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2015). Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2014). Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2020). *Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë* (i përditësuar deri në vitin 2024).
- Kryeministria e Shqipërisë. (2019). Urdhër nr. 93, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e strukturave shtetërore përgjegjëse për negociatat e aderimit”.

5. Jurisprudenca (Gjykata e Drejtësisë e BE-së)

- *Associação Sindical dos Juízes Portugueses*, Çështja C-64/16, ECLI:EU:C:2018:117 (Mbi pavarësinë e gjyqësorit si parim kushtetues).
- *Hungary v Parliament and Council*, Çështja C-156/21, ECLI:EU:C:2022:97 (Mbi mekanizmin e kondicionalitetit të sundimit të ligjit).
- *Pringle v Government of Ireland*, Çështja C-370/12, ECLI:EU:C:2012:756 (Mbi ligjshmërinë e ESM dhe stabilitetin e Eurozonës).
- *Gauweiler and Others v Deutscher Bundestag*, Çështja C-62/14, ECLI:EU:C:2015:400 (Mbi kufijtë e mandatit të BQE-së dhe politikën monetare).

Bazat e Qeverisjes Europiane – Cikël Leksionesh (Botimi i II-të, Gjirokastër, 2026)
Autor: Dr. Arjan Gjini | Projekti: EU4EduGovRegAL (Erasmus+ Jean Monnet Module 2025) | Të gjitha të drejtat të rezervuara